

V E N D I M

I mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te aksionerve te shoqerise anonime "Perpunim Pesticide" Durres date 16.01.2012.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionerve te Sh.A " Perpunim Pesticide" Durres ne mbledhjen e dates 16.01.2012, ku moren pjese **91.463 %** e aksionerve, qe ne baze te neneve 144, 145 e 146 te ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe statutit te Shoqerise , formon kuorumin e nevojshem dhe me rend dite:

- 1.Ndryshimet ne statutin e Shoqerise (Rishkrim i tij konform ligjit 9901 date 14.04.2008).
2. Zgjedhja e Keshillit te Administrimit te Shoqerise:

V E N D O S I

1.Miratimin e ndryshimeve ne Statutin e Shoqerise sipas draftit te dorezuar aksionerve dhe te konfirmuar (sigluar) prej aksionerve pjesemarres ne Mbledhje.(Rishkrim i statutit konform ligjit 9901 dt.14.04.2008.)

2. Zgjedhjen (emrimin) e 3 (tre) antarve te Keshillit te Administrimit te Shoqerise si me poshte:

- **Memo Memaj me aresim te larte finance.**
- **Adriana Sheti me aresim te larte eko.finanace.**
- **Engjell Hibroj me aresim te larte inxhimjer.**

Bashkangjitur me kete Vendim te Asamblese jane keto dokumenta.

-Proces-verbali i mbledhjes se Asamblese te Pergjithshme te Shoqerise te dates 16.01.2012, si dhe Ekstrakti i regjistrit te aksionerve.

Sekretari i Asamblese

(**Martin Gecaj**)



Kryetari i Asamblese

(**Memo Memaj**)





STATUTI I SHOQERISE ANONIME "PERPUNIM PESTICIDE" DURRES

KREU I PARE

Neni 1

Forma e shoqerise

Shoqeria anonime "Perpunim Pesticide" Durres do te jete shoqeri anonime pa oferte publike. Shoqeria anonime "Perpunim Pesticide" eshte formuar me akt themelimin dt 10.01.1997 dhe regjistruar si person juridik me vendimin e gjykates se rrethit Tirane Nr. Akt. 17327 dt 14.05.1997. Veprimtaria e Shoqerise do te rregullohet nga ky statut, dispozitat perkatese te ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe nga legjislacionine fuqi.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i plote i shoqerise eshte: **Shoqeria anonime "Perpunim Pesticide" Durres**. Ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga Shoqeria, emertimi i Shoqerise do te ndiqet nga fjalet "Shoqeri Anonime" ose inicialet Sh.A.

Neni 3

Selia e shoqerise

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: **Porto Romano –Durres**. A jo mund te transferohet ne cdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit te Administrimit por duhet te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Pergjithshme te Aksionerve.

Neni 4

Objekti i shoqerise

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise eshte:

Bluarje sqfuri, perpunim pesticide dhe ambalazhim, prodhim materiale ndertimi, import-eksport lendesh te para dhe produkte te gatshme, parking e transporte mallrash e produktesh.

Gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e siper marrjeve te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit, prodhim detalesh druri ose metali me porosi per te trete, kryerje te analizave kimike per ndotje ambjenti.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

KREU I DYTE

AKSIONET DHE AKSIONERET

Neni 6

Kapitali themeltar (regjistruar) i shoqerise

Kapitali themeltar (regjistruar) i shoqerise eshte 75 735 000 leke. Numuri i aksioneve eshte 75 735.

Vlera nominale e aksionit eshte 1 000 leke.

- 1.-Memo Memaj zoteron 38624,85 aksione ose 38 624 850 leke kap.-51%
- 2.-Shteti zoteron 30 672,67 aksione ose 30 672 670 lek kap.- 40,463%
- 3.-Punonj. (93pers.) zoterojne 6 437,47 aksione ose 6 437 470 lek kap.-8,4994%

Neni 7

Te drejttat dhe detyrat e aksionerve

Aksioneret e Shoqerise jane persona fizike ose juridike, qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te Shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji.

Pronesia mbi aksionet e Shoqerise permban aderimin me te drejta te plota ne statutin e Shoqerise nepermjet perfaqesimit ne asamlene e pergjithshme te aksionerve.

Cdo aksioner i Shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndarshme te Shoqerise ne perputhje me aksionet e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin e Shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje teprice nga likujdimi i kapitalit ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoteron.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamlene e pergjithshme te aksionerve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi

dhe ky statut. Votat qe zoterojne aksioneret jane propocionale me perqindjet e aksioneve qe zoterojne.

Neni 8

Llojet, format dhe numuri i aksioneve

Aksionet jane te formes emrore (nominative).

Ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e asamblese se pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave te aksionerve, sipas parashikimeve te nenit 145 te ligjit.

Pronesia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre ne emer te titullarit ose titullarve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e Shoqerise dhe nga ndermjetsat financiare.

Libri i aksionerve do te permbaje ne cdo kohe informatat: si numurin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiermrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Sejcili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje certifikate per te gjitha aksionet e cdo klase te zoteruara nga ai , kundrejt nja shume te paguar qe do te percaktohet nga asambleja e pergjithshme. Dorezimi i certifikates perfaqsesit te zoteruesve te perbashket te aksioneve do te konsiderohet se dorezim i kryer ndaj gjithe ketyre zoteruesve te perbashket.


Neni 9

Shitja dhe transferimi i aksioneve

Aksionet e Shoqerise jene lirisht te transferueshme (te shiten) tek te tretet, pa miratimin e Shoqerise.

Kontrata e kalimit te aksioneve behet me shkrim sipas formaliteve te percaktuara nga administratori pergjegjes per mbajtjen e regjistrit te Shoqerise,ose me akt noterial mbeshtetur nga certifikata e pronesis se aksioneve.

Personi qe fiton te drejten mbi nje pakete aksionesh si pasoje trashgimie(si aksioner), gezon te drejtat qe gezonte zoteruesi i aksioneve, menjehere me



dokumentimin perkates ligjor, si dhe regjistrimin ne regjistrin e aksioneve te Shoqerise si zoterues i aksioneve.

Neni 10

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund te ndryshohet me te gjitha menytrat dhe modalitet qe kerkon dhe lejon legjislacioni ne fuqi per kete qellim. Gjithashtu çdo i interesuar mund te kerkoje nga Gjykata kopetente prishjen e shoqerise. Prishja e Shoqerise nuk mund te shpallet ne rast se ne ditën qe Gjykata shqyrton çeshtjen, gjendja eshte rregulluar.

KREU III

Asambleja e pergjithshme

Neni 11

Thirrja e asamblese se pergjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët të paktën dy herë në vit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara në nenin 136 të Ligjit. Administratorët thërresin menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rast se kërkohet nga aksionarët e përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 139 të Ligjit.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo aksionari, përfshirë edhe përfaqësuesin e aksioneve në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën njëzet e një Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme janë te pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 12



Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

Nëse asnjë prej Anëtarëve të Këshillit të Administrimit nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

Një anëtar i Këshillit të Administrimit, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.


Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në pajtim me kuorumin e caktuar nga Ligji, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

Kryetari; ose

Aksionarët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i aksionarit ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë aksionari.

Me përjashtim të kundërshtimit të një aksionari, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar



ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes, përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 13

Votat e pjesemarrësve

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga aksionet, çdo aksion i jep aksionarit (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose aksionarit (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Asnjë aksionar nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme apo në mbledhjet e veçanta të zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me aksionet e zotëruara prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto aksione.

Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 14

Votimi me prokure

Përfaqësuesi do të emërohet nga një pjesëmarrës në mbledhje sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga anëtarët e Këshillit të Administrimit):

“.....ShA.....

Two handwritten signatures are visible in the bottom right corner. One is a large, stylized signature, and the other is a smaller, more compact signature. A long diagonal line is drawn across the page, passing through the space between the two signatures.

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më), ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 20.....”.

Në rastet kur dëshirohet tu jepet aksionarëve mundësia për ta udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët):

“.....ShA.....

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më), ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 *pro *kundër

Vendimi Nr. 2 *pro *kundër.

(*Fshini zgjedhjen e padëshiruar).

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më..... 20.....”.

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në zyrën qendrore të shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se

48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 15

Emrimi i eksperteve kontabel te autorizuar

Me propozim të Këshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për tre vjet me radhë, në pajtim me shkronjën "ç", pika 2, neni 135 të Ligjit. Emërimi bëhet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.

Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme, me vendim të asamblese se pergjithshme te marre me shumice te zakonshme.

Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton Këshillit të Administrimit, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

Kreu IV


Këshilli i Administrimit dhe Administratori

Neni 16

Emërimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Keshilli administrimit te Shoqerise do te perbehet me 3 antare.

Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e



Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.

Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Emërimi i Administratorëve

Këshilli i Administrimit zgjedh një person fizik si Administrator dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare, në pajtim me nenin 158 të Ligji. Vendimi i Këshillit të Administrimit, i cili miratohet me shumicën e thjeshtë të votave të keshillit, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

Neni 18

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

Këshilli i Administrimit udhëzon Administratorët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe Statutin. Detyrat e mbikëqyrjes së Këshillit të Administrimit, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", dhe "i" të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 154 të Ligjit, nuk mund t'iu delegohen Administratorëve



Ndryshimet e statutit dhe udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Këshillit të Administrimit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit

Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tij në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 nuk mund t'iu delegohen Administratorit.

Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 20

Skualifikimi dhe Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:

Personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë nenin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.

Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

Ka munguar për më shumë se dymbëdhjete muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.



Neni 21

Hetimet e Posaçme dhe Mbikëqyrja

Çdo person ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit ose për të kërkuar nga Këshilli i Administrimit që të kryejë detyrat e mbikëqyrjes në rastet e veçanta të parashikuara nga neni 165 i Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar i cili vërteton se ky/këta person/a plotësojnë kushtet për të kryer këtë veprim.

Neni 22

Shpërblimi dhe kostot e anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët do të kenë të drejtë të shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Këshilli i Administrimit dhe të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me pikën 1, neni 160 të Ligjit.

Neni 23

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.

Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit.



Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm.

Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëllor si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 24

Kufizimet në Votime

Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit të Administrimit mbi çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

Të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje; dhe

Te autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Zbatohet parashikimi i pikës 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.

Vota e anëtarit të Këshillit të Administrimit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.

Në rast se në mbledhjen e Këshillit të Administrimit diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtari të tij, çështja, përpara përfundimit të mbledhjes, mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit të Administrimit të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

Neni 25

Procesverbali i Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:

Te gjitha emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe

Te gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje

Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 26

Dividendët

Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.



Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Këshilli i Administrimit, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 27

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Këshilli i Administrimit, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 28

Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë vlerën e pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve



Neni 29Njoftimet

Çdo njoftim që u jepet ose kryhet nga persona sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jetë me shkrim është i vlefshëm në kohën e njoftuar për këtë qëllim personit i cili kryen njoftimin.

Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në pajtim me pikën 1 të nenit 121 të Ligji.

Miratuar ne mledhjen e pergjithshme te asamblese te mbajtur ne date 16 janar 2012.

Aksioneret:

1- Memo Memaj

2-Shteti perfaqsuar nga **Adriana Sheti**

Memo Memaj
Adriana Sheti

